

**STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR  
“SISTEMI ENERGIA” SHPK**

**PRONËSIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA**

**Neni 1**

**Ortakët**

- 1.1 Shoqëria “SISTEMI ENERGIA” SHPK (“Shoqëria”) është krijuar më datën si në vijim nga Ortakët si më poshtë:

**Z. Luca Frassanito**, shtetas italian, lindur më 30.04.1974 në Monteroni Di Lecce (Itali), madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. CA38032CB dhe me nr. personal FRSLCU74D30F604J; dhe

**Z. Gentjan Kole**, shtetas shqiptar, lindur më 27.08.1973 në Kuçovë dhe banues në Tiranë (Shqipëri), madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036201872 dhe me nr. personal H30827046P.

**Neni 2**

**Emri**

- 2.1 Emri i Shoqërisë është **“SISTEMI ENERGIA” SHPK.**

- 2.2 Në të gjithë dokumentat, faturat, reklamat dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht mjeteve të përdorura për trasmetim, emri i Shoqërisë do të përbëhet nga këto elementë:

- i. fjalët “*Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*” ose “*SHPK*”;
- ii. numri unik i identifikimit (NUIS);
- iii. kapitali i regjistruar dhe i paguar i Shoqërisë;
- iv. adresa e selisë; dhe
- v. njoftimi që shoqëria është në proces likuidimi, nëse është e aplikueshme

**Neni 3**

**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria do të ketë formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me legjisacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore në përputhje me parashikimet e ligjit shqiptar.

**Neni 4**  
**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**”) si dhe parashikime të tjera të zbatueshme të legjisacionit shqiptar.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

**Neni 6**  
**Selia / Adresa e regjistruar e Shoqërisë**

- 6.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. “Reshit Collaku”, Hyrja 1, Apartamenti nr. 38, Zona Kadastrale 8380, Nr. Pasurie 7/434+1-38, Tiranë, Shqipëri.
- 6.2 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mund të çelen ose mbyllen, në Shqipëri ose jashtë territorit, njësi dytësore biznesi, degë ose filiale.
- 6.3. Administratori(ët) mund të çelë ose mbyllë adresë sekondare të Shoqërisë në Shqipëri.

**Neni 7**  
**Objekti**

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do t'w jetë:

Import-eksport, shitje me shumicë dhe pakicë të një game të gjerë panelesh diellore, kontrollues karikimi, inverter, baterish, burime dhe ngarkesa ndihmëse të energjisë (pajisje), montim, matës gjenerimi, izolator DC, izolator AC, kuti siguresash, njehsor energjie, kabllo, gjurmues diellor dhe çdo artikull tjetër që lidhet me një panel diellor. Mirëmbajtja korriguese, parandaluese dhe parashikuese për impiantet fotovoltaike e kryer në bazë të raporteve të ekspertëve, kontolleve të sistemit, monitorimit të impiantit dhe bazuar në një plan të konsoliduar të mirëmbajtjes së sistemit fotovoltaik. Shërbime ndërmjetësimi për gjetjen e stafit teknik të nevojshëm për instalimin dhe mirëmbajtjen e impianteve fotovoltaike. Sigurimi i analizave, vlerësimeve dhe monitorimit të thelluar në lidhje me impiantet fotovoltaike.

- 7.2 Me qëllim përbushjen e objektit të mësipërm, Shoqëria ka të drejtë:

- Të lidhë çfarëdo lloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë, entitete private ose publike, Shoqëri, shtetin dhe organizata Shqiptare apo të huaja;
- Të themelojë të gjithë llojet e shoqërive ose të marrë pjesë në shoqëri shqiptare ose të huaja apo në bashkime shoqërish/joint venture ose në lloje të ndryshme biznesesh që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me atë të Shoqërisë;

- c. Të themelojë degë ose agjenci në Shqipëri ose jashtë territorit shqiptar;
  - d. Të përfaqësojë biznese shqiptare ose të huaja të lidhur me qëllimin e Shoqërisë;
  - e. Të marrë hua, të pranojë garanci personale ose të një lloji tjetër, të marrë përsipër detyrime, të lëshojë instrumente financiare të maturuara ose të maturueshme (*drafts ose bills of Exchange*), çeqe, obligacione ose garanci financiare apo tituj të tjerë për llogari të Shoqërisë dhe të lëshojë garanci të tjera kolaterale.
  - f. Të ndërmarrë çfarëdo aktiviteti të lidhur, tregtar ose të një lloji tjetër dhe të procedojë me çdo veprim ligor ose transaksion, drejtpërdrejt ose indirekt të lidhur me qëllimin e Shoqërisë, ose që kontribuon drejtpërdrejtë ose indirekt në përbushjen e qëllimit të Shoqërisë.
- 7.3 Shoqëria mund të realizojë në mënyrë plotësuese dhe rrjedhimisht në mënyrë rastësore dhe jo direkte, dhe në çdo rast vetëm me qëllim përbushjen e qëllimit të biznesit të Shoqërisë, çfarëdo transaksi apo aktiviteti tregtar, industrial apo finansiar në lidhje me pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që mund të konsiderohen të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektit të korporatës.
- 7.4 Shoqëria mund të kryejë operacione/veprime të tjera ndihmëse ose të lidhura, si dhe të gjithë aktivitetet e nevojshme ose të duhura me qëllim përbushjen e qëllimit të biznesit në përputhje me ligjin.
- 7.5 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose modifikohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 8**  
**Kapitali**

- 8.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë do të jetë 10,000 (dhjetë mijë) euro, i konvertuar në monedhën shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën e këtij statuti. Statuti përbëhet nga 2 (dy) kuota, si në vijim:
- (a) **Luca Frassanito**, i cili zotëron 1 kuotë që përfaqëson 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
  - (b) **Gentjan Kole** i cili zotëron 1 kuotë që përfaqëson 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 8.2 Secili prej Ortakëve do të kryejë pagesën respektive të pjesës së tij takuese të kontributit në para përkapitalin e Shoqërisë në llogarinë bankare të Shoqërisë të celur pranë çdo banke në Shqipëri, brenda 60 ditëve nga regjistrimi i Shoqërisë.

**Neni 9**  
**Transferimi i kapitalit/Kufizimet për transferimin**

- 9.1 Ortakët janë zotëruesit ekskluzivë të të gjitha kuotave të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- 9.2 Në rast transferimi të kuotës, ortakët gjëzojnë të drejtën e parablerjes. Për qëllim të këtij nenit, "trasferim i kuotës" do të thotë procesi i transferimit të kuotës ekzistuese, qoftë pjesërisht apo plotësisht, nga një ortak drejt një personi tjetër, i cili sjell në mënyrë direkte ose indirekte ndryshim në titullin e pronësisë ose të të drejtave mbi atë kuotë.

Nëse një ortak ("Shitësi") ka për qëllim të shesë kuotën e tij, qoftë pjesërisht ose plotësisht, drejt një pale të tretë, ai duhet fillimisht t'i propozojë një ofertë ortakut/ortakëve të tjerë (të ndryshëm nga Shitësi) të Shoqërisë ("Pranuesit e Ofertës"), në të cilën parashikohen kushtet dhe afatet e ofertës ("Njoftimi i Transferimit"), Njoftim i cili do të përfshijë kushtet dhe afatet e transferimit dhe në veçanti gjeneralitetet e blerësit(sve) potencialë, kohën që Shitësi do t'u japë ortakëve të tjerë për të marrë një vendim mbi ofertën e propozuar, kushtet e procesit të negociatave, çmimin e caktuar dhe metodat e pagesës.

Brenda 20 ditëve kalendarike nga data e marrjes së Njoftimit të Transferimit, ortaku/ortakët e interesuar për të ushtruar të drejtën e parablerjes duhet t'i përcjellin Shitësit një njoftim në formë të shkruar duke i konfirmuar vullnetin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Ortaku/ortakët e interesuar kanë të drejtë të blejnë kuotën e ofruar për shitje ose proporcionalisht me kontributin e tyre në kapitalin e Shoqërisë – dhe në përputhje me kushtet e Njoftimit të Transferimit, ose në tërësi në qoftë se e drejta e parablerjes nuk është ushtruar nga ortaku/ortakët e tjerë. Në rast se janë disa ortakë, të cilët do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për kuotën e ofruar për shitje, kuota do t'u shpërndahet ortakëve proporcionalisht me vlerën e kontributit të gjithësecilit në kapitalin e Shoqërisë. Çdo komunikim që nuk përbën informacionin e mësipërm është i pavlefshëm.

E drejta e parablerjes duhet të ushtron përshtatje për totalin e ofruar për shitje sipas Njoftimit të Transferimit dhe kundrejt çmimit të caktuar.

Përgjatë ushtrimit të të drejtës së parablerjes, nënshkrimi i marrëveshjes së shit-blerjes së kuotës dhe likuidimi i vlerës takuese duhet të kryhet në përputhje me afatet e specifikuara në Njoftimin e Transferimit, përvèç rasteve kur është dakortësuar ndryshe në formë të shkruar nga palët e kontratës së shit-blerjes së kuotës.

Në rast të transferimit të kuotës në favor të palëve të treta, pa respektuar parashikimet e mësipërmë, procesi i transferimit të kuotës do të cilësohet nul dhe blerësi nuk do të legitimohet për të ushtruar ndonjë të drejtë pronësie.

Në qoftë se asnjë nga ortakët nuk ushtron të drejtën e parablerjes sipas mënyrës së parashikuar më sipër, Shitësi mund të shesë kuotën e tij në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

- 9.3 Si përashtim nga rrregulli i parashikuar në pikën 9.2 më sipër, kuotat mund të transferohen lirisht në

çdo formë ndërmjet ortakëve dhe/ose ndërmjet ortakëve dhe përsonave të lidhur. Për efekt qartësie, personat e lidhur sipas këtij neni janë bashkëshortët dhe fëmijët e ortakëve.

**Neni 10**  
**Zmadhimi i Kapitalit**

- 10.1 Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet gjithashtu me nënshkrimin dhe shlyerjen e kuotave të reja nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 10.2 Kontributet e ortakëve mund të janë në çdo formë asetesh të lejuara nga ligji, duke përfshirë edhe kontributin në natyrë.
- 10.3 Ortakët mund të financojnë Shoqërinë nëpërmjet pagesave me interes apo pa interes, qoftë si formë e kontributit të tyre në kapital ose ndryshe, madje edhe subjekt i një detyrimi rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

**Neni 11**  
**Zvogëlimi i kapitalit**

- 11.1 Në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar do të kryhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni tregtar.

**STRUKTURA DRE|TUESE**

**Neni 12**  
**Asambleja e Përgjithshme**

- 12.1 Vendimet kryesore në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, i cili është organi më i lartë i Shoqërisë dhe që gjëzon të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.3 Vetëm Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë për çështjet si më poshtë:
  - a) ndryshimet e këtij statutit;
  - b) pranimin e ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit ose transferimit të kuotave);
  - c) të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin;
  - d) të vendosë mbi një bashkim, ndarje, shpërbërje dhe çdo forme tjeter transformimi të Shoqërisë;
  - e) për të vendosur për blerjen dhe/ose për të hequr dorë nga interesat pjesëmarrëse në shoqëri në Shqipëri dhe jashtë saj;
  - f) të themelojë dhe/ose mbyllë degë dhe zyra përfaqësimi jashtë territorit të Shqipërisë;
  - g) të miratojë raportet vjetore dhe bilancet dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
  - h) të vendosë mbi rregullat e brendshme për administrimin;
  - i) për të ngritur padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;

- j) të vendosë për blerjen, shitjen dhe vendosjen e barrëve mbi pasurinë e paluajtshme;
- k) të shpërndajë Shoqërinë;
- l) të caktojë shpërblimin e administratorit(ëve);
- m) të vendosë mbi caktimin e audituesve;
- n) të caktojë strukturën dhe orgazinimin administrativ të Shoqërisë;
- o) të caktojë buxhetin vjetor;
- p) të vendosë për çdo çështje tjeter, e cila i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme sipas ligjit dhe/ose këtij statuti.

### **Neni 13** **Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme**

- 13.1 Vendimet e listuara më sipër në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shpérndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpérndarjen e Shoqërisë do të miratohen me shumicë të cilësuar prej 3/4 të ortakëve të pranishëm në mbledhje, subjekt të kërkesës së kuorumi të nevojshëm sipas nenit 15 më poshtë (“Shumicë e Cilësuar”). Të gjithë vendimet e tjerë të Asamblesë së Përgjithshme mund të miratohen me shumicë të thjeshtë të ortakëve të pranishëm në mbledhje, subjekte të kuorumi të nevojshëm sipas nenit 15 më poshtë (“Shumicë e Thjeshtë”).

### **Neni 14** **Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

- 14.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të thirret nga Administratori/ët e Shoqërisë të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjeter siç përcaktohet nga njoftimi, brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të vitit të kaluar financiar të Shoqërisë.
- 14.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me ftesë me shkrim të lëshuar nga administratori/ët, me postë elektronike, e cila duhet të merret nga ortakët jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para datës së caktuar për mbledhjen. Ftesa për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të tregojë datën, orën dhe vedin e mbledhjes, si dhe pikat që do të diskutohen (rendi i ditës) dhe, në rast të një mbledhjeje të zakonshme vjetore të Asamblesë së Përgjithshme, duhet të përfshijë, gjithashtu, të pasqyrat e plota financiare vjetore dhe raportin e administrimit.

### **Neni 15** **Vendimet e miratuara në Asamblenë e Përgjithshme**

- 15.1 Në rast të vendimeve të miratuara me Shumicë të Thjeshtë, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit. Në rastin e vendimeve që kërkojnë Shumicë të Cilësuar, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit.

- 15.2 Kur Asamblesa e Përgjithshme nuk thirret siç parashikohet në nenin 14 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime vetëm nëse të gjithë ortakët e Shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje dhe bien dakord për të vazhduar, pavarësisht nga parregullsitë.
- 15.3 Ortakët njohin dhe pranojnë të drejtën për të marrë vendime për Shoqërinë në formë të shkruar. Vendimet e propozuara së bashku me dokumentacionin që mbështet vendimet do t'u dërgohen ortakëve nga Administratori/ët në përputhje me nenin 14.2. Ortakët do të vendosin për vendimet e propozuara brenda 10 (dhjetë) ditësh kalendarike nga data e marrjes së dokumentit që përmban tekstin e vendimeve, duke i kthyer brenda kësaj periudhe një kopje originale të nënshkruar të dokumentit tek administratori i Shoqërisë dhe, edhe me e-mail një kopje elektronike të saj. Ortakët që kundërshtojnë do t'u jepet mundësia të shprehin kundërshtimin e tyre për secilin vendim të propozuar me shkrim, në dokumentin që përmban tekstin e vendimit të propozuar. Vendimet me shkrim do të konsiderohen të miratuar nëse janë miratuar nga shumica dhe kuorumi i kërkuar. Për këtë qëllim, të gjithë ortakët mund të nënshkruajnë kopje të veçanta, por analoge të dokumentit që përmban tekstin e vendimit të propozuar.
- 15.4 Ortakët mund të miratojnë një vendim me shkrim në mungesë të formaliteteve të parashikuara në nenin 15.3 me kusht që të gjithë ortakët të pajtohen për miratimin dhe kalimin e një vendimi të tillë. Për këtë qëllim, të gjithë ortakët mund të nënshkruajnë vendime të veçantë, por analogë, kopja originale e nënshkruar e të cilave duhet t'i dërgohet Administratorit/ëve të Shoqërisë.
- 15.5 Prosesverbal i çdo mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme mbahet në përputhje me nenin 90 të ligjit për shoqëritë tregtare dhe nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe sekretari i procesverbalit. Kryetari i mbledhjes do të zgjidhet nga ortakët e pranishëm me shumicë të thjeshtë përparrë se mbledhja të fillojë të shqyrtojë rendin e ditës, ndërsa sekretari i procesverbalit caktohet nga Kryetari. Ortakët mund të vendosin që procesverbalit të mbahet nga një noter, e në këtë rast nuk është i nevojshëm caktimi i sekretarit të procesverbalit. Prosesverbalit nënshkruhet nga Kryetari dhe sekretari i procesverbalit/noteri. Ekstrakti i procesverbalit që përmban vendimet që janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me qëllim depozitim e tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit është i vlefshëm nëse nënshkruhet nga të gjithë ortakët e pranishëm në përfundim të mbledhjes. Vota kundërshtuese dhe nënshkrimi i ortakut/ëve kundërshtues duhet të pasqyrohet gjithashtu në ekstraktin e vendimit të miratuar në Asamblenë e Përgjithshme. Nëse nuk është e mundur që ekstrakti i procesverbalit që përmban vendimet e miratuarat të hartohet dhe të nënshkruhet menjëherë pas përfundimit të mbledhjes, administratori është përgjegjës për hartimin e tij dhe shpërndarjen e tij tek ortakët e pranishëm në mbledhje, nëpërmjet postës elektronike, brenda 3 (tre) ditë pune nga data e mbledhjes. Të gjithë ortakët mund të nënshkruajnë kopje të veçanta, por analoge të vendimeve në përputhje me vendimet e marra në mbledhje, kopja originale e nënshkruar e të cilit duhet t'i dërgohet administratorit/ve të Shoqërisë jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike pas marrjes së draftit. Nëse administratori nuk do të ketë mbledhur nënshkrimet e të gjithë ortakëve të pranishëm në mbledhje brenda afatit kohor të mësipërm, administratori është i autorizuar të depozitojë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ekstraktin e procesverbalit të vërtetuar nga Kryetari i mbledhjes.

**Neni 16**  
**Administratori**

- 16.1 Administrimi i përditshëm i Shoqërisë do të bëhet nga 1 (një) ose më shumë Administratorë të caktuar dhe emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse emërohet më shumë se 1 Administrator, ata do të kenë kompetenca dhe të drejta të përbashkëta në lidhje me menaxhimin e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur herë pas here vendoset ndryshe me vendim të ortakëve ose me këtë statut. Administratori(ët) e shoqërisë mëmë nuk mund të emërohen si administrator(ët) e filialit dhe anasjelltas.
- 16.2 Administratori/ët ka kompetenca të plota për administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe të drejtën për miratimin e të gjitha vendimeve që mund t'i duken të përshtatshme për të realizuar dhe ushtruar objektin e Shoqërisë, me përjashtim të veprimeve që sipas ligjit, këtij Statuti apo vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, të miratuara herë pas here, i takojnë Asamblesë së Përgjithshme. Me anë të një prokure administrator/ët mund të delegojë një ose më shumë nga të drejtat e tij në lidhje me menaxhimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë tek palë të treta.

Në veçanti, Administratori/ët ka të drejtat dhe detyrimet në vijim në lidhje me administrimin e Shoqërisë:

- a. drejtimin e veprimtarisë së përditshme të Shoqërisë, në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme, sipas rastit, të marra herë pas here;
  - b. përfaqësimin e Shoqërisë përballë palëve të treta dhe organeve publike;
  - c. çeljen e llogarive bankare të Shoqërisë;
  - d. lidhjen e marrëveshjeve me palët e treta;
  - e. lëshimi i faturave dhe zgjidhja e llogarive të pagueshme të Shoqërisë dhe pranimi i letrave me vlerë nga palët e treta;
  - f. punësimi dhe shkarkimi i stafit të Shoqërisë dhe caktimi i pagave dhe shpërblimeve të tjera në përputhje me politikat dhe udhëzimet e miratuara herë pas here nga Asambleja e Përgjithshme;
  - g. ndërmarrja e të gjitha veprimeve të tjera në lidhje me sigurimin e biznesit të zakonshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe e këtij statutit;
  - h. mbajtjen e librave kontabël të përcaktuar me ligj dhe parimet e kontabilitetit;
  - i. përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë dhe auditimi i tyre nga auditorët e jashtëm nëse kërkohet nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 16.3 Administratori/ët do të kryejë detyrën e tij për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, mandati i tij është i rinovueshëm, përveç rastit kur zëvendësohet sipas këtij Statuti. Në kryerjen e detyrës së tij, Administratori do të tregojë kujdesin e duhur të një personi të besueshëm dhe të ndërgjegjshëm të biznesit dhe do të respektojë fshehtësinë në lidhje me çështjet konfidenciale.
- 16.4 Administratori i parë i Shoqërisë, i emëruar për një mandat fillestar prej 2 vitesh është:

**Z. Gentjan Kole**, shtetas shqiptar, lindur më 27.08.1973 në Kuçovë dhe banues në Tiranë (Shqipëri), madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036201872 dhe me nr. personal H30827046P.

**Neni 17**  
**Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia**

- 17.1 Në vazhdim të detyrimeve të përcaktuara në Nenet 13, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të Shoqërive Tregtare, Administratori/ët duhet të:
- të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregetare dhe në këtë Statut me mirëbesim dhe në interesin e Shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vëmendje të veçantë impaktit që ka aktiviteti i shoqërisë në mjesid;
  - të ushtrojë detyrën e tij në përputhje me të drejtat që i jepen nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe ky Statut vetëm për qëllimet e përcaktuara këtu;
  - t'i kushtojë vëmendjen e duhur çështjeve për të cilat duhet të marrë vendim;
  - të shmangë çdo konflikt aktual dhe të mundshëm ndërmjet interesave të tij personale dhe atyre të Shoqërisë;
  - të ushtrojë funksionet e tij me kujdesin dhe vëmendjen e duhur;
  - të vë në dispozicion të Asamblesë së Përgjithshme çdo të dhënë të lidhur me biznesin, të kërkuara nga Asambleja e Përgjithshme, brenda një kohe të arsyeshme dhe jo më vonë se 7 (shtatë) ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të janë të përditësuara.

**Neni 18**  
**Eksperti/ët Kontabël i/të Miratuar**

- 18.1 Eksperti/ët Kontabël i /të miratuar do të caktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nëse është e nevojshme. Mandati i audituesit, nëse caktohet një i tillë, duhet të rinovohet çdo vit.

**Neni 19**  
**Viti Financiar**

- 19.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, që fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të secilit vit.

**Neni 20**  
**Bilanci. Kontabiliteti**

- 20.1 Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe duhet të përgatitet dhe t'i paraqitet organeve tatimore përpala fundit të Marsit të vitit pasues.
- 20.2 Librat kontabël duhet të mbahen në gjuhën Shqipe dhe vlerat përcaktohen në monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të ndara në monedhë të huaj, dhe këto shuma do të

konvertohen çdo muaj në monedhën vendase.

- 20.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim, Shoqëria mund të vendosë si garanci kuotat e saj, ose mund të vendosë të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 21**  
**Likuidimi**

- 21.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë shpërbërjen e Shoqërisë.
- 21.2 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme do të emërohet një likuidator ose një grup likuidatorësh, të cilët do të merren me procedurat e likuidimit.
- 21.3 Likuidatori/Likuidatorët do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban gjendjen e përgjithshme të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për kryerjen e këtij likuidimi. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Përgjithshme do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë mbylljen e procedurës së likuidimit.

**Neni 22**  
**Ndryshimet në Statut**

- 22.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të modifikohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.


**Neni 23**  
**Dispozita Përfundimtare**

- 23.1 Ky Statut përgatitet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Angleze dhe Shqipe. Në rast se ka mospërputhje midis këtyre dy versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën Angleze.

Nënshkruar më 12.05.2023 nga:

**ORTAKËT**

**LUCA FRASSANITO**



**GENTJAN KOLE**





## Kursi zyrtar

Periudha kohore	12.05.2023 - 12.05.2023
Monedha e zgjedhur	Euro (EUR)
Data	Lekë për njësi të monedhës së huaj
12.05.2023	110.82

Kapitali i Shqipërisë (Neni 8 i Statutit)

Kapitali në euro

10.000 (dijetë mijë)

Kursi i kombinët në  
datën e statutit  
(12.05.2023)

110.82

Kapitali në lekë

$$10.000 \times 110.82 = \underline{\underline{1,108,200 \text{ lekë}}}$$

Bazuar në nenin 8.1 të statutit të Shqipërisë, kapitali fillostar  
i soy do të jetë 1,108,200 lekë

Në eni është përmes llogaritës

Perfapësuesi me proturë

Elvira Mema